



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i Lëndës Makroekonomia

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Makroekonomia
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Obligative
Vitii studimeve:	I (semestri II)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Në kuadër të lëndës mësohet për matjen e GDP-se, problemet e matjes së GDP-se, mbi rritjet dhe rëniet ciklike të prodhimit, produktin total të të mirave dhe shërbimeve dhe rritjen e tij, normat e inflacionit dhe të papunësisë, bilancin e pagesave dhe kurset e këmbimit, Modeli IS-LM, Modeli Mundell Fleming, faktorë që ndikojnë në mosfleksibilitetin e pagave.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi në lëndën "Bazat e Makroekonomisë" është të prezantojë konceptet dhe terminologjinë kryesore të makroekonomisë dhe të shpjegojë se si të aplikohen disa instrumenta të analizës makroekonomike. Kjo lëndë ka gjithatë për qëllim të ofrojë një kornizë teorike në të cilën si efektet afatshkurtëra dhe afatgjata makroekonomike të politikës monetare dhe fiskale dhe monetare do të gjejnë aplikim në praktikë dhe si do të bëhet vlerësimi për suksesshmërinë e tyre.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e lëndës studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë se si matet dhe vlerësohet preformanca ekonomike në nivelin kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke mësuar teoritë të cilat shpjegojnë përcaktorët e të ardhurave kombëtare, rritjes

	ekonomike,punëzënjes,inflacionit,normave të interesit,konsumit,kursimit si në ekonominë e mbyllura ashtu edhe në ekonominë e hapura.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanëk të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 5 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë.			
Metodologjia e mësimdhënies:	- Mënyra e të mësuarit do të jetë përmes ligjeratave dhe ushtrimeve (me studime rasti dhe me punime seminarike do të realizohen ushtrimet). - Mësimi do të zhvillohet në grupe. Për çdo segment të një ligjerate përgaditet prezantimi edhe në sllajdeku u prezantohet studentëve rregullat, principet themelore të njësive mësimore. - Në çdo pjesë të ligjeratës për katëse studentët aktivizohen me komente, pyetje dhe shpjegime plotësuese si rezultat të pyetjeve. - Studentët kanë komoditet që të komentojnë, pyesin dhe të shpjegojnë dilemat dhe pakartësit eventuale, gjithnjë me një rend dhe disiplinë adekuate. - Një ditë në javë, pra pas përfundimit të mësimit mbaj konsultime me studentët edhe pse studentët e gëzojnë të drejtën e komunikimit përmes postës elektronike. - Në ushtrime, krahas zgjidhjes së detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen		

	diskutime për problemet e ndryshme financiare globale, rajonale apo vendore si dhe zgjidhja e këtyre problemeve.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë: ✓ Të vijueshmërisë dhe angazhimit të tyre, ✓ detyrave me shkrim ✓ suksesit në kollokviume si dhe ✓ provimit përfundimtar.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Makroekonomia (Ribotimi I). Musa Limani, Prishtinë, 2013 2. Mançellari, A., Hadëri, S., Kule, Dh. dhe Qirici, S. (2007): Hyrje ne Ekonomi. Shtëpia botuese Pegi, Tiranë.
Literatura shtesë:	1. "Macroeconomics" edicioni i 10-të, Dornbusch, Fischer, Startz. 2008 The McGraw – Hill Companies, Inc. 2. "Makroekonomia Aplikative", Prof. Dr Musa Limani, Prishtine 2008.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i Syllabusit
Java e dytë:	Hyrje në Makroekonomi
Java e tretë:	Ekulibri Makroekonomik
Java e katërt:	Konsumi dhe Investimet
Java e pestë:	Shpenzimet dhe Të Ardhurat
Java e gjashtë:	Ciklet e Biznesit Dhe Rritja ekonomike
Java e shtatë:	Inflacioni
Java e tetë:	Tesi I
Java e nëntë:	Papunësia
Java e dhjetë:	Raporti Inflacion-Papunësi
Java e njëmbëdhjetë:	Paraja Dhe Sistemi Bankarë
Java e dymbëdhjetë:	Banka Qendrore Dhe Politika Monetare
Java e trembëdhjetë:	Politika Fiskale
Java e katërmëdhjetë:	Marrëdhënjet Ekonomike Ndërkombëtare dhe Plotikat e Tregtisë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.